

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 648 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 87, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të *projektit për "Shtesë Anësore, Dyqane Ikat, me vendndodhje rruga "Hysen Mushketa", në zonën arkeologjike "B", Durrës"*, paraqitur nga Z. Idriz Byku,

VENDOSI:

1. Z. Idriz Byku duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të depozitohet pranë ASHA "Konceptin e kryerjes së një sondazhi" në sheshin e ndërtimit dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë kryerjen e këtij sondazhi nga ky subjekt.
2. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
3. Raporti i sondazhit arkeologjik të paraqitet në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë dhe procedura e shqyrtimit dhe vendimarrjes do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të këtij Këshilli.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYËTAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

